

## Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin “**Specialistit Gjeolog në Qendrën e Prodhimit të Naftës Kuçovë**” një kandidat profesionist në fushën e inxhinierisë së naftës, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

<b>Arsimimi</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Diplomë në Inxhinieri Naftë në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja.</li><li>Diplomë Master dhe certifikata të njohura në fushën e inxhinierisë.</li></ul>
<b>Eksperiencë pune</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Preferohet të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune si Inxhinier Naftë në sektorin e naftës.</li><li>Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm.</li></ul>
<b>Cilësitë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.</li><li>Aftësi për të planifikuar, menaxhuar, ndjekjen e detyrave dhe komunikimi në të gjitha nivelet e Shoqërisë Anonime;</li><li>Aftësi për të trajtuar informacion konfidencial në mënyrë të ndjeshme;</li><li>Aftësi për të kryer shumë detyra, për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e kërkuara.</li><li>Nivel i lartë integriteti dhe besueshmërie me një ndjenjë të fortë efikasiteti dhe orientimi të rezultateve.</li></ul>

Kandidatet që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që dëshirojnë të aplikojnë duhet të dërgojnë kërkesën e tyre, së bashku me CV; Fotokopje e Diplomës; Fotokopje e librezës së punës, dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. ose në adresën [bnj@albpetrol.al](mailto:bnj@albpetrol.al)

Kërkesat pranohen deri më datën 27 Tetor 2020, ora 16:00

Personat e përzgjedhur do të kontaktohen nga shoqëria Albpetrol sh.a.